



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, Gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 shkurt 2023

Gjuha: Anglisht

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mocion të Rishikuar për Provat Jogojore
dhe Pezullim e Zgjatje Afati**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

Trupi Gjykues II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 9(5)(a) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 shkurt 2023, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë për pranimin e provave jogojore ("Mocioni i Provave Jogojore"), që përmbante tetë shtojca dhe materiale voluminoze të parashtruara nga ZPS-ja për pranim.¹

2. Më 14 shkurt 2023, Mbrojtjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ("të akuzuarit" dhe "Mbrojtja") dorëzuan bashkërisht një përgjigje urgjente ndaj Mocionit të Provave Jogojore ("Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes").²

3. Më 17 shkurt 2023, ZPS-ja dorëzoi kundërpërgjigjen e saj ndaj Përgjigjes Paraprake të Mbrojtjes ("Kundërpërgjigjja").³

II. PARASHTRIMET

4. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të materialeve të ndara në gjashtë kategori të përgjithshme.⁴

5. Mbrojtja përgjigjet se, meqenëse Mocioni i Provave Jogojore përfshin 1260 materiale që arrijnë në thujse 13500 faqe, ata nuk kanë kohë t'i përgjigjen Mocionit të Provave Jogojore, gjë që cenon të drejtën e të akuzuarve për të pasur kohë dhe mjete të

¹ F01268, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 8 shkurt 2023, me shtojcat 5 dhe 8, dhe shtojcat 1-4, 6 dhe 7, konfidenciale.

² F01289, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje Paraprake Urgjente e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së ZPS-së për Pranimin e Provave Jogojore*, 14 shkurt 2023.

³ F01301, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes Paraprake Urgjente të Përbashkët të Mbrojtjes për Kërkesën e ZPS-së për Pranimin e Provave Jogojore*, 17 shkurt 2023.

⁴ Mocioni i Provave Jogojore, para. 2

mjaftueshme.⁵ Gjithashtu Mbrojtja parashtron se Mocioni i Provave Jogojore është i mangët dhe nuk ndjek udhëzimet e Trupit Gjykues.⁶ Konkretisht, Mbrojtja parashtron se ZPS-ja: (i) nuk ka saktësuar lidhjen e materialeve të propozuara me provat e ZPS-së;⁷ (ii) nuk ka përcaktuar me cilët paragrafë të Aktakuzës lidhet secila nga provat materiale;⁸ (iii) nuk ka përcaktuar çfarë numra faqesh duhen pranuar nga librat dhe dokumentet voluminoze;⁹ (iv) nuk ka paraqitur përkthime të dokumenteve për të cilët e ka pasur detyrë ta bëjë;¹⁰ (v) nuk i është përmbajtur rregullës 138(2) për nxjerrjen e gjithë informacionit relevant të rregullave 102(1)(b), 102(3) dhe 103;¹¹ dhe (vi) nuk ka nxjerrë të gjitha provat lidhur me dëshmitë e ekspertëve në procese të tjerë.¹² Në përputhje me këtë, Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykues të urdhërojë ZPS-në ta parashtojë përsëri Mocionin e Provave Jogojore me qëllim që të plotësojë kriteret e lartpërmendura dhe ta shtyjë afatin e përgjigjes ndaj Mocionit të Provave Jogojore deri gjashtë javë pasi ZPS-ja të ketë dorëzuar versionin e rishikuar të Mocionit të Provave Jogojore.¹³

6. ZPS-ja përgjigjet se kërkesa e Mbrojtjes duhet hedhur poshtë sepse ZPS-ja iu është përmbajtur udhëzimeve të Trupit Gjykues dhe se Mbrojtja ka të gjithë informacionin e nevojshëm për t'i u përgjigjur Mocionit të Provave Jogojore.¹⁴ ZPS-ja nuk e kundërshton zgjatje të arsyeshme të afatit që Mbrojtja t'i përgjigjet Mocionit të Provave Jogojore.¹⁵

⁵ Përgjigje Paraprake e Mbrojtjes, para. 1-2.

⁶ Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes, para. 15, 38(i).

⁷ Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes, para. 17, 38(i)(a).

⁸ Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes, para. 18-19, 38(i)(b).

⁹ Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes, para. 20-21, 38(i)(c).

¹⁰ Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes, para. 22, 38(i)(c).

¹¹ Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes, para. 23-26, 38(i)(d).

¹² Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes, para. 28-34, 38(i)(e).

¹³ Përgjigjja Paraprake e Mbrojtjes, para. 6, 38(ii).

¹⁴ Kundërpërgjigjja, para. 1, 7, 13.

¹⁵ Kundërpërgjigjja, para. 1, 13.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Në bazë të rregullës 9(5)(a) nëse i jepen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, trupi gjykues mund të zgjasë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej trupit gjykues.

IV. DISKUTIM

A. NËSE MOCIONI I PROVAVE JOGOJORE TË ZPS-SË PËRPUTHET ME URDHRA TË TRUPIT GJYKUES

8. Trupi Gjykues do të trajtojë vetëm Përgjigjen Paraprake të Mbrojtjes. Vlerësimi i kriterëve për pranimin e provave materiale të propozuara do të bëhet gjatë përcaktimit të themelësisë së Mocionit të Provave Jogojore dhe duke marrë parasysh edhe përgjigjen e Mbrojtjes për të.

9. Trupi Gjykues hedh poshtë plotësisht pretendimin e Mbrojtjes se Mocioni i Provave Jogojore nuk plotëson kriteret e vëna nga Trupi Gjykues. Trupi Gjykues e ftoi ZPS-në të paraqiste një mocion të provave jgojore që konkretisht “të kishte lidhje me: (a) provat materiale që ajo propozonte të merrte nga lista e provave materiale të saj që mendonte se do t’i përdorte për secilin nga të 40 dëshmitarët; dhe (b) materialet provuese që ZPS-ja i konsideron të rëndësishme për një paraqitje të qartë dhe të efektshme të provave të saj në këtë fazë.”¹⁶ Rrjedhimisht, ZPS-ja (i) ishte njëkohësisht e autorizuar nga Rregullorja dhe i përmbushi udhëzimet e Trupit Gjykues, (ii) dhe Mocioni i saj i Provave Jogojore ishte brenda kuadrit të asaj që konsiderohet si “paraqitje e qartë dhe e efektshme e provave në këtë fazë.”

10. Për çdo provë materiale të propozuar ZPS-ja i referohet paragrafit ose paragrafëve me të cilat ajo pretendon se ka lidhje dokumenti përkatës. Gjithashtu, ZPS-ja ka përvijuar edhe relevancën që synohet të ketë secila provë materiale e

¹⁶ Transkript i seancës, 16 dhjetor 2022, f. 1775 (urdhri i katërt gojor).

propozuar. Pretendimi i Mbrojtjes se ZPS-ja nuk ka arritur të paraqesë konkretisht relevancën që ka sipas saj secila provë materiale dhe që kjo mangësi justifikon urdhrin që ZPS-ja të dorëzojë rishtazi Mocionin e saj të Provave Jogojore nuk mbështetet as në Rregullore, as në Urdhrin e Trupit Gjykses mbi Zhvillimin e Gjykimit .

11. ZPS-së ka detyrimin të përcaktojë kushtet e pranimin të materialeve të paraqitura. Se sa i plotësojnë ato këto kushte, kjo do të vendoset nga Trupi Gjykses kur të përcaktohet themelësia e Mocionit të Provave Jogojore në lidhje me çdo material të paraqitur. Për më tepër, Trupit Gjykses nuk i është paraqitur ndonjë e dhënë që provat materiale të jenë siguruar në kundërshtim me Ligjin, me Rregulloren ose me standardet e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, që në këto rrethana do të justifikonte mjetin ligjor të kërkuar nga Mbrojtja sipas rregullës 138(2). Gjithashtu, Mbrojtja nuk ka mundur të përcaktojë se cili material, sipas saj, përfshihet në kuadrin e nenit 37 të Ligjit dhe në lidhje me çfarë pretendohet se nuk përputhet Mocioni i Provave Jogojore.

12. Në përgjigje të Mocionit të Provave Jogojore, Mbrojtja duhet të japë një përmbledhje të kundërshtimeve të saj për pranimin e materialeve të caktuara dhe të shprehë qartë arsyet dhe bazën e kundërshtimeve.

13. Faktin që disa nga dokumentet e ofruara nga ZPS-ja përmbajnë vetëm një përkthim të pjesshëm në anglisht të origjinalit shqip Trupi Gjykses e kupton si tregues që ZPS-ja është përpjekur të ofrojë si dëshmi vetëm pjesën ose pjesët e përkthyer të dokumenteve në fjalë. Rregullorja nuk e detyron ZPS-në të paraqesë përkthim të plotë të dokumentit dhe nuk kërkon pranimin e pjesëve të tjera të pa përkthyer. Megjithatë, nëse për dhënien e kontekstit të duhur të parashtrimeve të ZPS-së nevojiten përkthime të tjera të teksteve, Trupi Gjykses mund ta kërkojë këtë përpara se të marrë në shqyrtim pranimin.

14. Në përputhje me këtë, Trupi Gjykses e hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes që ZPS-ja të paraqesë një Mocion të rishikuar të Provave Jogojore.

B. ZGJATJA E AFATIT

15. Trupi Gjykues konstaton se, në bazë të rregullës 9(5)(a), Mbrojtja ka paraqitur arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit për t'iu përgjigjur Mocionit të Provave Jogojore duke marrë parasysh afatet e shumta që duhet të respektojnë palët dhe pjesëmarrësit dhe volumin, në kuptimin e numrit të dokumenteve në fjalë, të Mocionit të Provave Jogojore. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues u lejon Mbrojtjes dhe mbrojtësit të viktimave zgjatjen e afatit për t'iu përgjigjur Mocionit të Provave Jogojore deri të **martën, 21 mars 2023**. Zgjatja jepet duke synuar që të krijohen sa më shumë mundësi për t'i dhënë Mocionit të Provave Jogojore përgjigje esenciale dhe të racionalizuara, në mënyrë që gjatë procesit të gjyqimit të sigurohet efikasiteti dhe shpejtësia dhe, rrjedhimisht, të mos u shkaktohet dëm palëve apo pjesëmarrësve. Nëse do të jepet përgjigje, për të do të zbatohet afati i parashikuar nga rregulla 76. Trupi Gjykues fton ekipet e Mbrojtjes të shohin mundësinë e dorëzimit të një përgjigjeje të përbashkët ndaj Mocionit të Provave Jogojore, në mënyrë që të zvogëlohet koha dhe sasia e burimeve që nevojiten për trajtimin e kësaj pike.

V. VENDIM

16. Për arsyet e mësipërme, Trupi Gjykues:

- a. **HEDH POSHTË** kërkesën e Mbrojtjes që ZPS-ja të paraqesë përsëri Mocionin e Provave Jogojore me ndryshimet e kërkuara;
- b. **MIRATON** kërkesën e Mbrojtjes për zgjatje të afatit të dorëzimit të përgjigjes ndaj Mocionit të Provave Jogojore; dhe
- c. **ZGJAT** deri të martën, 21 mars 2023 afatin për Mbrojtjen dhe mbrojtësin e viktimave për t'iu përgjigjur Mocionit të Provave Jogojore.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 21 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë